


**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**

I

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Teknologja Shqiptare” SHPK**



# AKT THEMELIMI DHE STATUT “Teknologja Shqiptare” SHPK

## Kreu I

### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

#### Neni 1

##### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Bazuar në Kushtetutë dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe në ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 për Q.K.B (Qëndra Kombëtare e Biznesit):

1. Sot më 10.04.2023 ne,
- ❖ **Eduard Dragusha** shtetas Shqipetar, lindur me **26.04.1983** Mjede Shkoder, banues ne Shqiperi, identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **I30426139W**

dhe

**Tecnologia Ambiente SRL**, Person Juridik i themeluar ne **Itali Bergamo** me daten **27.12.2018** P.IVA, 04339310163 me numer: **BG-455483** rregjistrimi ne repertorin ekonomik administrativ. Me seli ne **Bergamo, Albano Sant Alessandro, Via Tonale, 74 CAP 24061**.

vendosem per te krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

#### “Teknologja Shqiptare” SHPK

#### Neni 2

#### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Import-eksport, dhe perpunim guri,mermeri,graniti, tregtim me shumice e pakice i gurit,mermerit,granitit dhe materialeve te ndertimit, ,tregtim dhe transportimin i materialeve inerte si: rera,zhvavore,gure,çakull,gelqere,granile dhe materiale te ndryshme per ndertim, Prerje blloku mermeri,guri,graniti, tregtim i nenprodukteve te mermerit dhe granitit , Tregtim me pakice dhe shumice i lastrave te mermerit dhe granitit si dhe Import-eksport i tyre sipas kerkeses,ndertime,rikonstruksione,ndertime godina banimi shumekateshe,ndertim vila,pallate, rruge,punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge,punim restaurimi te ndertesave te ndryshme., e qe konsiderohet i pershtatshem per rritjen dhe zhvillimin e metejshem te aktivitetit te shoqerise.



# AKT THEMELIMI DHE STATUT “Teknologja Shqiptare” SHPK

## Neni 3

### Kohëzgjatja

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

## Neni 4:

### Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Zyra rregjistrimit Shkoder, Z-K nr: 2015, Nr-Pasurie:179/16 Volumi/3 Faqe/ 190, Kaçë.**

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

- a. Tecnologia Ambiente - [tecnologia.ambiente@pec.it](mailto:tecnologia.ambiente@pec.it)
- b. Eduard Dragusha - [eduard.dragusha@hotmail.it](mailto:eduard.dragusha@hotmail.it)

## KREU II

## KAPITALI

### Neni 5

### Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është **2 400 000 Lekë** (Dymilion e katerqind mijë leke)
- (2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
- a. Ortaku Z. Eduard Dragusha : Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **40%** të kapitalit themeltar të shoqërisë(960,000 Leke)
  - b. Ortaku Technologia Ambiente Srl : Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **60%** të kapitalit themeltar të shoqërisë(1,440,000 Leke)
- Tecnologia Ambiente SRL, Person Juridik i themeluar ne Itali Bergamo me daten 27.12.2018 P.IVA, 04339310163 me numer: BG-455483 rregjistrimi ne repertorin ekonomik administrativ. Me seli ne Bergamo, Albano Sant Alessandro, Via Tonale, 74 CAP 24061.

# AKT THEMELIMI DHE STATUT “Teknologja Shqiptare” SHPK

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë(pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

## Neni 6:

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autoriazuar per këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën mase ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shit-blerjes;
- c) Trashigimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**Kreu III**

**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**

**Organi vendimmarrës**

Ortaket e shoqerise jane organet e vetme vendimmarres te shoqërisë.

Ortaket e shoqerise jane organet e vetme vendimmarres te shoqërisë që miratojne cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaket janë përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërine për çeshtjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqerisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emerimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Percaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veritarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Cdo ndryshim i statutit rregjistrohet sipas ligjit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

# AKT THEMELIMI DHE STATUT “Teknologja Shqiptare” SHPK

## Neni 9 Administrimi

(1) Ortaket emërojne një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqerisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin ë tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

### Të dhënat e identifikimit:

- ❖ **Z. Eduard Dragusha** shtetas Shqipetar, lindur me **26.04.1983** Mjede Shkoder, banues ne Shqiperi, identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **I30426139W** do te jete administrator

## Neni 10 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tragtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- Përgatisin dhe nënshkruejë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, paraqesin keto dokumente perpara asamblese së përgjithshme për miratim;

# AKT THEMELIMI DHE STATUT “Teknologja Shqiptare” SHPK

- Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat,që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryejnë rregjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë,sic parashikohet në ligjin për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare,dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratoret janë të detyruar të thërrasin asamblene e përgjithshme në rastet kur:
- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë një mënyrë tjetër active,të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë,që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara..

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se 1 administrator ,ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme.Paditë që lidhen me shpqrblimin e administratorit ,në bazë të mardhënieve kontraktore me shoqërinë,rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Nenj 11 Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht,ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve,për shkelje të ligjeve,për shkëlje të statutit,apo për faje te kryera gjatë administrimit të shoqërisë.Pasojet e marrëveshjeve te pamiratuara nga asambleja që I sjellin dëm shoqërisë,I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bërë marrveshjen,për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht,sipas rastit,pasojet përkatëse

Perveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë,sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,administrator detyrohet;

1.

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara ne ligj dhe ne statut në mirëbesimin dhe interesin më të mirë të shoqërisë në tërsë,duke I kushtuar vëmëndje të veçante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;

# AKT THEMELIMI DHE STATUT “Teknologja Shqiptare” SHPK

- b) Te ushtrojë kompetencatqë I njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi çeshtjet,për të cilat merret vendimi;
- d) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit,present apo të mundshëm,të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2.Administratori,gjatë kryerjes së detyrave të tij,përgjigjen ndaj shoqërisë për cdo veprim apo mosveprim,që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare,me përashtim të rasteve kur,në bazë të hetimit dhe vlersimit të informacioneve përkatëse,veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

3.Nëse administrator vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale,sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit,është I detyruar t’l dëmshpérblejë shoqërisë dëmet,që rrjedhin nga kryerja e shkeljes,si dhe ti kaloje cdo fitim personal që ata apo pësonat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.Administratori ka barren e proves për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator,ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4.Në mënyrë të veçantë por pa u kufizuar në to,administrator është I detyruar ti dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara,nëse,në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,kryen veprimet e mëposhtme;

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interest apo dividentë;
- c) U shpérndanë aktivet shoqërisë;
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare,kur,në bazë të gjëndjës financiare,duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishtë aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që I ngarkohet personalisht administratorit,ortakët individualisht ose së bashku,kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që I është shkatuar shoqërisë,përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar,nëse është e nevojshme.Asnjë vendim I asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit të detyrës

# AKT THEMELIMI DHE STATUT “Teknologja Shqiptare” SHPK

---

## Kreu IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

### Neni 12

#### Viti finanziar

Viti finanziar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti I parë fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

### Neni 13

#### Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithe dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike te ushtruar prej tij, përrastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë te tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike te ushtruar të cilat është i detyruar, qe t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve, për t'l shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendore që ka.

## KREU V PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISE

### Neni 14

#### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”
- e) Me vendim të gjykates;

# AKT THEMELIMI DHE STATUT “Teknologja Shqiptare” SHPK

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë, mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatoren dhe shënuar në cdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”

Prishja e shoqërive tregtare ka sipasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga oratkët.

Nëse oratkët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brënda 30 ditëve pas prishjes, cdo përsone i interesuar mund ti drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.

## Neni 15

### Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara ne pjesen IX te Ligji 9901 date 14.04.2012 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

## Neni 16

### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjetër specific ne Republikën e Shqipqrisë.

## Neni 17

### Mosmarrveshjet


Për mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

## ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.

Tecnologia Ambiente SRL

Z.Eduard Dragusha

(Administrator)



Jurgen Kola

